



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.06.2020 merr këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PAKOS EKONOMIKE EMERGJENTE

I.

MIRATOHET Vendimi për pakon ekonomike emergjente "Prishtina 2".

II

Sipas pikës I të këtij vendimi, kjo pako përfshin masat, si në vijim:

1. Sigurimi i pakove higjienike dhe ushqimore, në vlerë prej 100,000.00 €;
2. Pajisje shëndetësore dhe buxhet për dezinfektim, në vlerë prej 100,000.00 €;
3. NPL "Stacioni i Autobusëve" do të subvencionohet për pagat e muajit maj, në vlerë prej 80,000.00 euro.
4. Çerdhet me bazë në komunitet paguajnë pagat nga të hyrat e pagesës së prindërve. Këto çerdhe do të subvencionohen për pagat e punëtorëve, kostoja e të cilave është 50,000.00 € në muaj;
5. Subvencione për sport, ku shuma prej 50,000.00 € i ndahet klubit futbollistik "Prishtina" dhe shuma prej 50,000.00 € i ndahet klubit futbollistik "Flamurtari";
6. Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe QSE "SOS-Kopshti" u ndahen sipas nevojës deri në 70,000.00 €.



7. Do të themelohet një program i granteve për biznese, të vetëpunësuarit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, i cili do t'i ndihmojë bizneset që dëshmojnë humbjet nga masat restriktive. Vlera e këtij fondi do të jetë 5,000,000.00 €.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtorja e Financave dhe drejtoritë tjera relevante.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0088887/20, më 11.06.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

